

Ndikimi financiar i masave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës



Maj 2025

Ndikimi financiar i masave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës

Maj 2025

Përmbledhje ekzekutive

Bashkimi Evropian (BE) është partner kyç në zhvillimin ekonomik, politik dhe institucional të Kosovës, duke kontribuar me më shumë se 1.5 miliard euro për reforma dhe mbështetje gjatë periudhës 2007-2020. Megjithatë, marrëdhëniet mes Kosovës dhe BE-së kanë hyrë në një fazë të re, veçanërisht pas tensioneve në veri të Kosovës gjatë vitit 2023. Si pasojë e këtyre zhvillimeve, që nga qershori i vitit 2023, BE ka vendosur masa ndëshkuese ndaj Kosovës, të cilat kanë ndikuar negativisht në marrëdhëniet dypalëshe dhe në mbështetjen financiare nga BE. Puna e organeve në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) ishte ndërprerë deri në maj të vitit 2025, fondet për Kosovën në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA) janë pezulluar, dhe propozimet e Kosovës në Kornizën e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) nuk janë duke u shqyrtuar nga Bordi i WBIF. Për më tepër, Kosova nuk është përfshirë në ngjarje të nivelit të lartë, përveç atyre që lidhen me situatën në veri dhe integrimin rajonal të Ballkanit Perëndimor. Për heqjen e këtyre masave nevojitet një konsensus i plotë i vendeve anëtare të BE-së, ku deri më tani nuk është marr ndonjë vendim i tillë.

Masat e vendosura nga Bashkimi Evropian ndaj Kosovës kanë rezultuar me pasoja të theksuara financiare dhe zhvillimore, duke i kushtuar Kosovës rreth 613.4 milionë euro në projekte të pezulluara ose të shtyra për një afat të pacaktuar. Brenda kësaj shume, për shkak të kalimit të afateve të lejuara për nisjen e procedurave për projekte të caktuara, 7.1 milionë euro janë humbur tërësisht. Sektorët më të prekur përfshijnë mjedisin me 350.7 milionë euro, energjinë me 114.4 milionë euro, digjitalizimin me rreth 57 milionë euro dhe kulturën me 15 milionë euro. Nga gjithsej mjetet e ndikuara nga masat, rreth 218 milionë euro janë projekte në kuadër të IPA (IPA II dhe IPA III) dhe rreth 395.5 milionë euro janë projekte në kuadër të WBIF. Realizimi i këtyre projekteve ishte parashikuar të financohej përmes granteve dhe kredive, me një kontribut prej rreth 421 milionë euro nga Bashkimi Evropian, afërsisht 162 milionë euro nga palët e treta sikurse institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe vetëfinancim në vlerën prej 31 milionë euro.

Këto vonesa në fillimin e zbatimit të projekteve nënkuptojnë shtyrje ose humbje të mundësive për rritje, zhvillim dhe përmirësim të mirëqenies së qytetarëve, si dhe ndikojnë negativisht perspektivën për integrim evropian. Qëllimi i këtij raporti të shkurtër është të ofrojë një pasqyrë të mbështetjes financiare që Kosova ka marrë nga BE dhe të analizojë ndikimin e masave ndëshkuese të BE-së ndaj Kosovës duke evidentuar humbjet dhe pasojat zhvillimore që kanë rezultuar nga pezullimi i projekteve dhe fondeve të BE-së.

1. Hyrje

Bashkimi Evropian (BE) ka luajtur një rol kyç në zhvillimin ekonomik, politik dhe institucional të Kosovës që prej vitit 1999, përmes mekanizmave të ndryshëm si Procesi i Stabilizim-Asociimit (ang. SAP), ofrimi i ndihmës financiare dhe teknike, si dhe pranisë së institucioneve të saj në Kosovë. Këto përpjekje janë pasuar nga investime të konsiderueshme në fusha si forcimi i administratës publike, përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe mbështetje për reformat në drejtësi dhe ekonomi. Gjithashtu, BE ka promovuar bashkëpunimin rajonal për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe ka kontribuar në forcimin e sundimit të ligjit dhe zhvillimin demokratik të vendit.¹

Kosova ka përfituar nga një sërë instrumentesh financiare të Bashkimit Evropian, ndër të cilat veçohen fondet nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit në BE (IPA) dhe Korniza Investuese në Ballkanin Perëndimor (WBIF). Gjatë peridhues 2007-2020, BE ka investuar gjithsej mbi 1.5 miliard euro, përmes marrëveshjeve IPA I dhe IPA II dhe instrumenteve të tjera, për reforma institucionale, zhvillim ekonomik dhe integrim evropian të Kosovës. IPA, e krijuar nga BE në vitin 2007, ka mbështetur Kosovën në periudha të ndryshme.² Nga IPA I (2007-2013), Kosova ka përfituar projekte në vlerë 633.9 milionë euro.^{3 4} Nga IPA II (2014-2020), Kosova ka përfituar 573.1 milionë euro. Përveç kësaj, Kosova ka marrë mbështetje edhe nga programet ndërkufitare dhe rajonale të IPA I dhe II.⁵ Po ashtu, në përgjigje të pandemisë, ka mobilizuar mbi 150 milionë euro për mbështetje të drejtpërdrejtë.⁶

Për IPA III (2021-2027), deri më tani ekzistojnë tri marrëveshje të nënshkruara midis Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian për vitet 2021, 2022 dhe 2023. Gjatë dy viteve të para (2021 dhe 2022), BE së bashku me palët e treta ka kontribuar mesatarisht 87.8 milionë euro në vit për Kosovën, duke mbështetur fusha kyçe si sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik, reformat në administratën publike, energjia e ripërtrishme dhe bashkëpunimi rajonal. Përveç fondeve nga marrëveshjet IPA, Kosova ka përfituar dhe nga WBIF, një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian, institucioneve financiare dhe donatorëve dypalësh, e cila ka për qëllim të rrisë bashkëpunimin dhe të mbështesë zhvillimin socio-ekonomik në

¹European Union Office in Kosovo. [Dokument pune i personelit të Komisionit. Raporti për Kosovën – 2023](#). Qasur së fundmi: 11 mars 2025

² [European Commission](#). Instrument for Pre-accession Assistance (IPA). Qasur së fundmi: 11 mars 2025

³ European Commission. [Instrument for Pre-accession Assistance \(IPA\). Kosovo](#). Qasur së fundmi: 11 mars 2025

⁴ Komisioni Evropian, [IPA - Instrumenti për Asistencë të Para-Anëtarësimit. Fokus i ri i Asistencës së BE-së për zgjerim](#). Qasur së fundmi: 11 mars 2025

⁵ European Commission. [Instrument for Pre-accession Assistance \(IPA\). Kosovo](#). Qasur së fundmi: 11 mars 2025

⁶ European Union Office in Kosovo. [Relations with the EU. The European Union and Kosovo. An overview of relations between the EU and Kosovo](#). Qasur së fundmi: 11 mars 2025.

Ballkanin Perëndimor.⁷ WBIF ka financuar gjithsej 298.9 milionë euro në formë të granteve, nga të cilat 253.6 milionë euro ishin grante për investime dhe 45.3 milionë euro grante për asistencë teknike. Këto grante kanë mbështetur projekte investive në sektorë të ndryshëm, përfshirë ujësjellësin, mbrojtjen nga përmbytjet, transportin, energjinë e ripërtrishme, ngrohjen qendrore dhe furnizimin me gaz, si dhe ndihmën për ndërtimin e objekteve shëndetësore dhe infrastrukturën e internetit me shpejtësi të lartë.⁸

Megjithatë, nga qershori i vitit 2023, pas tensioneve në veri të Kosovës ku u organizuan zgjedhje të cilat u bojkotuan nga qytetarët serbë, dhe më pas edhe pati një sulm të dhunshëm ndaj Policisë së Kosovës, BE ka ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj Kosovës si: ndërprerja e punës së organeve në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (deri në maj të vitit 2025⁹), pezullimi i fondeve në kuadër të Instrumentit IPA si dhe aplikimeve të reja në WBIF, pezullimi i nënshkrimit të kontratave të reja dhe mos-përfshirja në ngjarje të nivelit të lartë.¹⁰

Ky raport paraqet koston e të gjitha projekteve të ndikuara nga këto masa, duke përfshirë vetëm ato për të cilat ishte paraparë financim apo kishin kaluar fazat e nevojshme vlerësuese, si dhe bën ndarjen e tyre nëpër fusha.

2. Kosto totale e masave të BE-së për Kosovën (qershor 2023 – prill 2025)

Masat e vendosura nga Bashkimi Evropian ndaj Kosovës kanë rezultuar me pasoja të theksuara financiare dhe zhvillimore, duke i kushtuar Kosovës rreth 613.4 milionë euro në projekte të pezulluara ose të shtyra për një afat të pacaktuar. Brenda kësaj shume, për shkak të kalimit të afateve të lejuara për nisjen e procedurave për projekte të caktuara, 7.1 milionë euro janë humbur tërësisht, përmes të cilave parashihej mbështetje për bujqësinë dhe turizmin rural, rritjen e konkurrencës së ndërmarrjeve, dhe më shumë. Këto masa kanë ndikuar drejtpërdrejt në zbatimin e projekteve të financuara përmes fondeve IPA (rreth 218 milionë euro) dhe WBIF (395.5 milionë euro) duke bllokuar kështu nënshkrimin dhe zbatimin e tyre. Nga fondet IPA janë ndikuar tri marrëveshje të nënshkuara (2020, 2021 dhe 2022) dhe një marrëveshje e paproceduar (2024). Kurse nga Korniza e Investimeve për Ballkanin

⁷ Zyra e Kryeministrit (ZKM). [Kosova përfiton grante nga Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor, në vlerë prej 57.6 milionë euro](#). Qasur së fundmi me 11 mars 2025. WBIF. [Economic and Investment Plan for the Western Balkans 2021-2027](#). Qasur së fundmi me 11 mars 2025.


⁸ Ibid.

⁹ Radio Evropa e Lirë. [Cilat prej masave ndëshkuese ka filluar BE-ja t'ia heqë Kosovës?](#). Qasur së fundmi më 23 maj.

¹⁰ Këshilli i Evropës. [Njoftim për media - Kosova* - Deklaratë nga Përfaqësuesja e Lartë në emër të BE-së mbi zhvillimet e fundit](#). Qasur së fundmi më 11 mars.

Perëndimor (WBIF) janë bllokuar tetë aplikime për grante dhe kredi, dy gjatë vitit 2023 dhe gjashtë gjatë vitit 2024.


Figura 1. Kosto e masave të BE-së për Kosovën (gjithsej 613.4 milionë euro)



Burimi: Të dhënat e përpunuara nga Instituti GAP, me burim nga Zyra e Kryeministrit (ZKM). Për IPA 2024 të dhënat janë marrë nga dokumenti i Agjendës së Reformave të Kosovës.

Sektorët më të prekur përfshijnë mjedisin me 350.7 milionë euro, energjinë me 114.4 milionë euro, digjitalizimin me rreth 57 milionë euro dhe kulturën me 15 milionë euro.


Figura 2. Sektorët më të ndikuar prej masave të BE-së për Kosovë



Burimi: Të dhënat e përpunuara nga Instituti GAP, me burim nga Zyra e Kryeministrit (ZKM)

Realizimi i këtyre projekteve ishte parashikuar të financohej përmes granteve dhe kredive, me një kontribut prej rreth 421 milionë euro nga Bashkimi Evropian, afërsisht 162 milionë euro nga palët e treta, si dhe vetëfinancim në vlerën e rreth 31 milionë euro.

Figura 3. Ndikimi financiar i masave të BE-së për Kosovën në projekte të financuara nga WBIF dhe IPA (gjithsej 613.4 milionë euro)



Burimi: Të dhënat e përpunuara nga Instituti GAP, me burim nga Zyra e Kryeministrit (ZKM)

Vonesat në realizimin e projekteve, të shkaktuara kryesisht nga masat e vendosura nga Bashkimi Evropian ndaj Kosovës, nuk përbëjnë vetëm pengesë teknike në rrjedhën e financimit, por janë duke u përkthyer në humbje konkrete për shoqërinë. Ato ndikojnë drejtpërdrejt në humbjen e përfitimeve të pritshme socio-ekonomike si dhe në rritjen e kostove financiare për zbatimin e mëvonshëm. Kur një projekt në fushën e energjisë apo arsimit nuk realizohet në kohë, ai përkthehet në kushte jo të përshtatshme për mësim apo në shpenzime më të larta për ngrohje, që rëndojnë mbi buxhetin publik dhe individual. Për më tepër, vonesat e vazhdueshme cenojnë besueshmërinë e institucioneve vendore ndaj partnerëve ndërkombëtarë dhe pengojnë fonde të reja. Realizimi i projekteve në kohën e planifikuar nuk është thjesht çështje teknike e menaxheriale, por një domosdoshmëri strategjike për të ruajtur ritmin e reformave, për të sjellë përfitimet tek qytetarët në kohën e duhur dhe për të forcuar kredibilitetin institucional në procesin e integritimit evropian.

2.1 Kosto e masave të BE-së në Programin IPA për Kosovën

Si rezultat i masave të vendosura nga Bashkimi Evropian, nga qershori 2023 deri në prill 2025 janë pezulluar dhe humbur projekte të financuara nga fondet IPA II dhe IPA III. Më konkretisht, nga fondi IPA II është ndikuar marrëveshja e vitit 2020, ndërsa nga IPA III janë ndikuar marrëveshjet e viteve 2021 dhe 2022. Po ashtu, marrëveshja e paraparë për IPA 2024 është planifikuar të programohet në marrëveshjen IPA 2025-2027. Nga këto tri marrëveshje IPA (2020-2022) dhe IPA 2024 janë pezulluar projekte me vlerë rreth 218 milionë euro¹¹, ndërsa nga kjo shumë janë humbur përfundimisht 7.1 milionë euro, të cilat nuk do të mund të përfshihen në asnjë marrëveshje të re në të ardhmen. Më konkretisht, nga kontributi i drejtpërdrejt i BE-së janë pezulluar 172 milionë euro, nga kontributi i palës së tretë 30.3 milionë euro dhe nga kontributi i Kosovës 8.4 milionë euro.

Tabela 1. Marrëveshjet IPA nën masa të BE-së


	Gjithsej shuma e projekteve nën masa	Të humbura	Kontributi i BE-së nën masa	Kontributi i palës së tretë	Kontributi i Kosovës
Marrëveshja IPA 2020	€ 32,100,000	€ 7,100,000	€ 17,600,000	-	€ 7,400,000
Marrëveshja IPA 2021	€ 37,500,000	-	€ 35,700,000	€ 800,000	€ 1,000,000
Marrëveshja IPA 2022	€ 91,830,000	-	€ 62,250,000	€ 29,580,000	-
Marrëveshja IPA 2023	E pa ndikuar nga masat				
IPA 2024 (planifikim)	€ 56,455,000	-	€ 56,455,000	nuk dihet	nuk dihet
Gjithsej	€ 217,885,000	€ 7,100,000	€ 172,005,000	€ 30,380,000	€ 8,400,000

Burimi: Instituti GAP duke shfrytëzuar të dhënat zyrtare nga Zyra e Kryeministrit. Për IPA 2024 të dhënat janë marrë nga dokumenti i Agjendës së Reformave të Kosovës.

Nga fondet IPA II, nga marrëveshja IPA 2020, janë pezulluar projekte me vlerë totale prej 32.1 milionë euro. Ndër projektet e pezulluara përfshihet një projekt kyç për sektorin e energjisë (ndërtimi i sistemit të ngrohjes qendrore), me vlerë prej 25 milionë euro. Përveç këtij projekti të pezulluar, janë humbur edhe projekte me vlerë 3 milionë euro në fushën e konkurrueshmërisë dhe inovacionit, që përfshinin grante për digjitalizimin dhe rimëkëmbjen e bizneseve; dy projekte në fushën e sundimit të ligjit me vlerë 1.3 milion euro; si dhe tri projekte të tjera me vlerë të përgjithshme prej 2.8 milionë euro, të cilat i përkasin sektorëve të bujqësisë dhe turizmit rural.

¹¹ Pa e përfshirë kontributin e palëve të treta për IPA 2024, ndonëse veç ekziston një [listë](#) aktiviteteve që ishte sugjeruar për të qenë pjesë e pakos.

Figura 4. Projektet nën masa të financuara nga Marrëveshja IPA 2020 sipas sektorëve dhe burimeve të financimit



Burimi: Instituti GAP duke shfrytëzuar të dhënat zyrtare nga Zyra e Kryeministrit

Tutje, nga fondet IPA III, nga Marrëveshja e vitit 2021, masat e ndërmarra kanë ndikuar në pezullimin e 10 projekteve, me një vlerë të përgjithshme prej 37.5 milionë euro. Nga këto, pjesa më e madhe ishte kontributit i Bashkimit Evropian, 35.7 milionë euro, ndërsa pjesa tjetër vetëfinancim (1 milion euro) dhe kontribute të tjera (800 mijë euro).


Si rezultat, janë prekur projekte në fusha të ndryshme. Nga mjedis, janë pezulluar tri projekte me vlerë prej 16 milionë euro, përfshirë projektin për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Kosovën B (12 milionë euro). Nga bujqësia dhe zhvillimi rural, janë pezulluar dy projekte me vlerë 10 milionë euro, të cilat lidhen me zhvillimin rural dhe sigurinë ushqimore. Nga ekonomia e tregut dhe konkurrueshmëria, janë pezulluar tri projekte me vlerë 5.5 milionë euro, që kryesisht kanë të bëjnë me mbështetjen e tregtisë, ngritjen e kapaciteteve teknike për standardizim dhe përputhshmëri me BE, forcimin e mekanizmave të kontrollit të tregut dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit. Më tej, nga fusha e zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe administratës publike, janë pezulluar 3 milionë euro për programin e bursave “Young Cell Scheme”, i cili mbështet të rinjtë nga Kosova për studime në Bashkimin Evropian, 1 milion euro për forcimin e kapaciteteve administrative, si dhe 2 milionë euro për administratën tatimore.

Figura 5. Projektet nën masa të financuara nga Marrëveshja IPA 2021 sipas sektorëve dhe burimeve të financimit



Nga fondet IPA III, marrëveshja e vitit 2022 është vënë në tërësi nën masa, çka nënkupton se janë pezulluar projekte në vlerë prej 92.3 milionë euro. Nga kjo shumë, 62.3 milionë euro ishte kontributi i BE-së ndërsa rreth 30 milionë euro ishin kontribut i palës së tretë (kredi, etj). Rreth 32.6% (apo 20.3 milionë euro) e kontributit nga BE ishin të planifikuara për programet që përfshijnë afrimin me BE-në, të drejtat themelore dhe zhvillimin social e ekonomik. Kurse, 67% e fondeve, ose rreth 42 milionë euro, ishin dedikuar për sektorët e mjedisit dhe energjisë. Ky program kishte për qëllim financimin e projekteve në fushat e energjisë, mbrojtjes së ambientit dhe zhvillimit profesional.


Figura 6. Projektet nën masa nga Marrëveshja IPA 2022 sipas sektorëve dhe burimeve të financimit



Ndryshe nga marrëveshjet paraprake, Marrëveshja IPA 2023 nuk është ndikuar nga masat e vendosura nga BE-ja. Kjo për faktin se 90% e fondeve të kësaj marrëveshjeje janë transferuar menjëherë pas nënshkrimit. Marrëveshja përfshin një grant prej 75 milionë eurosh, i cili është dedikuar kryesisht për sektorin e energjisë.¹²

Ndërkohë, IPA 2024 nuk ka hyrë në procedurë dhe nuk është nënshkruar dhe lidhur me të, BE ka udhëzuar që projektet e planifikuara për vitin 2024 të përfshihen në kuadër të programimit të IPA 2025–2027.¹³ Projektet e planifikuara në kuadër të IPA 2024 kishin vlerën prej gjithsej 56.4 milionë euro, ku përfshihen projekte nga fusha e energjisë me vlerë 16.5 milionë euro, nga kultura me vlerë 15 milionë euro, nga edukimi i hershëm dhe arsimi me vlerë 10 milionë euro, nga drejtësia me vlerë 6.2 milionë euro, dhe të tjera.¹⁴

Figura 7. Komponentët e planifikuar në IPA 2024 të ndikuara nga masat e BE



Burimi: Instituti GAP duke shfrytëzuar të dhënat zyrtare nga Zyra e Kryeministrit

Pezullimi i këtyre mjeteve nuk e ndikon vetëm rrjedhën e financimit, por e ngadalëson zhvillimin ekonomik, dobëson kapacitetet për përballje me sfida të mëdha si tranzicioni energjetik, mbrojtja e mjedisit dhe vendet e reja të punës, si dhe pengon ndërtimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme për qytetarët.

¹² Gazeta Zyrtare. [Marrëveshje Financiare Kushtet e Vecanta](#). Qasur së fundmi: 11 prill 2025.

¹³ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Raporti vjetor financiar 2024. Qasur së fundmi: 11 prill 2025.


¹⁴ [Agjenda-e-Reformave-te-Kosoves](#)

2.2 Kosto e masave të BE-së në projektet e Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor në Kosovë (WBIF)

Aplikimet e Kosovës në kuadër të Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor (WBIF) të dorëzuara gjatë viteve 2023 dhe 2024, nuk kanë kaluar më tej për miratim. Si pasojë, disa projekte kyçe, të cilat ishin të bashkëfinancuara nga Agjencia Franceze për Zhvillim (AFD), Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe institucione të tjera ndërkombëtare, nuk janë duke u realizuar.¹⁵

Më saktësisht, në periudhën qershor 2023 – prill 2025, janë pezulluar aplikime për projekte në vlerë prej 395.5 milionë euro. Nga gjithsej vlera e projekteve prej 395.5 milionë euro, 94.6 milionë euro ishin të planifikuara si grante nga Bashkimi Evropian, 154 milionë euro kredi nga Bashkimi Evropian, 78.2 milionë euro kredi nga financues të tjerë dhe rreth 15.3 vetëfinancim.

Figura 8. Projektet nga WBIF sipas burimit të financimit




Burimi: Të dhënat e përpunuara nga Instituti GAP, me burim nga Zyra e Kryeministrit (ZKM)

Projektet e pezulluara janë në sektorë si mjedisi me 271 milionë euro, energjia me 74.5 milionë euro dhe digjitalizimi me 50 milionë euro.

¹⁵ WBIF. Përgjigje ndaj kërkesës zyrtare të Institutit GAP.


Figura 9. Projektet nën masa të financuara nga WBIF sipas sektorëve dhe burimeve të financimit



Burimi: Instituti GAP duke shfrytëzuar të dhënat zyrtare nga Zyra e Kryeministrit

Në kuadër të këtyre projekteve që nuk janë proceduar gjatë vitit 2024 për shkak të masave përfshihen: rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit në Prishtinë, impianti për trajtimin e ujërave në Ferizaj, linja ndërlidhëse energjetike Kosovë–Shqipëri, rikonfigurimi i rrjetit ekzistues, si dhe investime në infrastrukturën digjitale dhe të dhënave dhe ndërtimi i infrastrukturës kundër përmbytjeve dhe për ujitje.

Figura 10. Projektet me vlerat më të mëdha të pezulluara të WBIF



Burimi: Instituti GAP duke shfrytëzuar të dhënat zyrtare nga Zyra e Kryeministrit

3. Përfundim

Masat e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës kanë rezultuar në pezullimin apo shtyrjen e projekteve me një vlerë totale prej rreth 613.4 milionë euro, të cilat ishin buxhetuar por nuk ishin kontraktuar ende. Projektet e pezulluara përfshijnë mjedisin me 350.7 milionë euro, energjinë me 114.4 milionë euro, digjitalizimin me rreth 57 milionë euro dhe kultura me 15 milionë euro. Pezullimi i investimeve të tilla ka sjellë pasoja të menjëhershme dhe afatgjata, si vonesa në ndërtimin e infrastrukturës, humbje të mundësive për punësim, përkeqësim të kushteve të jetesës dhe pengesë në përmbushjen e objektivave mjedisore e integruese. Për shembull, objektet e ndryshme banesore dhe institucionale vazhdojnë të operojnë në mënyrë jo-eficiente, me kosto të lartë të energjisë dhe duke ndikuar negativisht në mjedis, ndërsa moszbatimi i projekteve në transport vonon integrimin në rrjetin evropian dhe ul potencialin ekonomik të vendit. Mungesa e investimeve në arsim dhe përfshirje sociale përkthehet në më pak mundësi për të rinjtë dhe komunitetet jo-shumicë. Përtej kostos së drejtpërdrejtë financiare, këto vonesa përfaqësojnë një kosto të lartë oportuniteti, pasi çdo vonesë apo projekt i lënë pezull nënkupton shtyrje ose humbje të mundësive për rritje, zhvillim dhe përmirësim të mirëqenies së qytetarëve, si dhe zbehje të perspektivës për integrim evropian dhe forcim institucional.

4. Aneks

Lista e projekteve nën masa të financuara nga IPA 2020

Projekti	Gjithsej	Humbur	Pezulluar	Të tjera	Bashkëfinancim i Kosovës
Akademia e Drejtësisë	€ 300,000	€ 300,000	-	-	-
Mbështetje për Sistemin e Menaxhimit të Rasteve (CMIS)	€ 1,000,000	€ 1,000,000	-	-	-
Mbështetje për ngrohjen qendrore - TERMOKOS	€ 25,000,000	-	€17,600,000	-	€ 7,400,000
Menaxhim direkt: Mbështetje për vreshtat dhe veraritë	€ 800,000	€ 800,000	-	-	-
Menaxhim direkt: Rigjenerimi i rrugës Marin Barleti	€ 1,200,000	€ 1,200,000	-	-	-
Menaxhim direkt: Kinemaja "Lumbardhi"	€ 800,000	€ 800,000	-	-	-
Menaxhim direkt: Digjitalizimi dhe rimëkëmbja e bizneseve – grante	€ 3,000,000	€ 3,000,000	-	-	-
Gjithsej	€ 32,100,000	€ 7,100,000	€17,600,000	-	€ 7,400,000

Burimi: Të dhënat e përpunuara nga Instituti GAP, me burim nga Zyra e Kryeministrit (ZKM)

Lista e projekteve nën masa të financuara nga IPA 2021

Projekti	Gjithsej	Humbur	Pezulluar	Të tjera	Bashkëfinancim i Kosovës
Mbështetje për tatimin në pronë	€ 2,000,000	-	€ 2,000,000	-	-

Programi për përafrimin me legjislacionin e BE-së dhe masat mbështetëse – komponenti Skema Young Cell	€ 4,000,000	-	€ 3,000,000	-	€ 1,000,000
Impiante për trajtimin e ujërave të zeza në Kosovën B	€ 12,000,000	-	€ 12,000,000	-	-
Përgatitja e projektit për Mbështetjen e BE-së për fazën 3 për Ajr të Pastër (ulja e SOx)	€ 2,000,000	-	€ 2,000,000	-	-
Mbështetje për menaxhimin e deponive në Kosovë (KLFM)	€ 2,000,000	-	€ 2,000,000	-	-
Mbështetje për tregtinë	€ 2,000,000	-	€ 2,000,000	-	-
Cilësi, në përputhje me kërkesat e BE-së	€ 2,500,000	-	€ 2,500,000	-	-
Mbikëqyrja e tregut dhe mbrojtja e konsumatorit	€ 1,000,000	-	€ 1,000,000	-	-
Mbështetje për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	€ 7,700,000	-	€ 7,000,000	€700,000	-
Mbështetje për fushën fitosanitare	€ 2,300,000	-	€ 2,200,000	€100,000	-
Gjithsej	€ 37,500,000	-	€ 35,700,000	€800,000	€ 1,000,000

Burimi: Të dhënat e përpunuara nga Instituti GAP, me burim nga Zyra e Kryeministrit (ZKM)

Lista e projekteve nën masa të financuara nga IPA 2022

Veprimi	Gjithsej	Kontributi i BE-së	Kontributi i palës së tretë
BE për të drejtat themelore	€ 8,880,000	€ 6,800,000	€ 2,080,000

Përafrimi me BE	€ 7,000,000	€ 7,000,000	-
BE-ja për mjedisin dhe energjinë e ripërtrishme	€ 68,850,000	€ 41,950,000	€ 26,900,000
BE-ja për zhvillimin socio ekonomik gjithëpërfshirës	€ 7,100,000	€ 6,500,000	€ 600,000
Gjithsej:	€ 91,830,000	€ 62,250,000	€ 29,580,000

Burimi: Të dhënat e përpunuara nga Instituti GAP, me burim nga Zyra e Kryeministrit (ZKM)

Lista e projekteve projekteve nën masa të financuara nga WBIF

Viti	Lloji	Projekti	Gjithsej	Grant nga WBIF	Hua nga WBIF	Grante të tjera	Hua tjetër	Bashkëfinancim nga Kosova
2023	Investim	Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimeve në Prishtinë	€ 165,251,140	€ 90,000,000	€ 20,000,000	-	€ 53,351,140	€ 1,900,000
2023	Asistencë Teknike	Impianti i ujit në Ferizaj	€ 7,450,000	€ 350,000	€ 3,850,000	€ 2,850,000	-	€ 400,000
2024	Asistencë Teknike	Rehabilitimi dhe ndërtimi i infrastrukturës për mbrojtjen nga përmbytjet dhe për sistemet e ujitjes	€ 66,181,195	€ 1,760,000	€ 39,421,195	€ 20,000,000	-	€ 5,000,000
2024	Asistencë Teknike	Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Ferizaj	€ 32,125,000	€ 750,000	€ 8,679,000	€ 21,471,000	-	€ 1,225,000
2024	Asistencë Teknike	Linja e re e ndërlidhjes 110KV SS-Deçan (Kosovë) - S.S. Bajram Curri (Shqipëri)	€ 3,840,000	€ 170,000	€ 2,104,000	€ 1,316,000	-	€ 250,000

2024	Asistencë Teknike	Rikonfigurimi i rrjetit 400 kV dhe ndërlidhja e re 400 kV Shqipëri – Kosovë	€ 70,682,000	€ 400,000	€ 47,800,000	€ 15,982,000	-	€ 6,500,000
2024	Asistencë Teknike	Infrastrukturë moderne për të dhëna dhe shërbime të inteligjencës artificiale	€ 20,000,000	€ 600,000	€ 12,600,000	€ 6,800,000	-	-
2024	Asistencë Teknike	Promovimi dhe mbështetja e përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese të internetit fiks në Rrjete me Kapacitet shumë të Lartë	€ 30,000,000	€ 600,000	€ 19,600,000	€ 9,800,000	-	-
Gjithsej			€ 395,529,335	€ 94,630,000	€ 154,054,195	€ 78,219,000	€ 53,351,140	€ 15,275,000



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP përkrahët nga:



Ndikimi financiar i masave të
Bashkimit Evropian ndaj Kosovës

Maj 2025

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE

